

SHTYLLA III: SUNDIMI I LIGJIT

II. MBROJTJA, RESPEKTIMI DHE MEKANIZMAT GARANTUES TË TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT

II.C MBROJTJA, RESPEKTIMI DHE MEKANIZMAT GARANTUES TË SË DREJTËS PËR NJË PROCES TË RREGULLT LIGJOR

(Përmbledhje ekzekutive)

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në vitin 2016 amendamentet kushtetuese të reformës në drejtësi dhe një sërë ligjesh të konsideruara – *paketa e reformës* – të cilat e bënë të mundur zbatimin e reformës në praktikë për të pasur një sistem gjyqësor, i cili funksionon në bazë të ligjit, që është i pavarur dhe i paanshëm, duke përmbushur kështu kriteret për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe avancimit drejt integritimit në Bashkimin Evropian.

Kryerja e rivlerësimit kalimtar të të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve e ndihmësve ligjor është kryer në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, proces i cili synon të garantojë mbajtjen në sistem të subjekteve, të cilët përmbushin kushtet e deklaramit të pasurisë, integritetit të figurës dhe aftësive profesionale. *Procesi i vetingut ka rritur nivelin e llogaridhënies së subjekteve të gjyqësorit, por duhet theksuar se metodat e vlerësimit të magistratëve dhe anëtarëve jomagjistratë të Këshillave, mbeten tepër të rëndësishme për të garantuar pavarësinë e sistemit dhe perceptimin e publikut për të.*

Ndërkohë, **aksesi në gjykatë përmes përfaqësimit**, si element tepër i rëndësishëm i të drejtës për një proces të rregullt, është garantuar nga miratimi i ligjit nr. 111/2017 “*Për ndihmën ligjore të garantuar nga shteti*”, si dhe gjithë paketa e akteve nën-ligjore të miratuara për zbatimin e tij, të cilat kanë krijuar kuadrin e nevojshëm institucional dhe ligjor për funksionimin e kësaj të drejte. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.111/2017, mekanizmi i aksesit në drejtësi dhe ofrimit të ndihmës juridike falas, u bë i mundur jo vetëm për grupet që janë të dobëta ekonomikisht, por edhe për të gjithë subjektet që mund të konsiderohen vulnerabël për shkak të statusit të veçantë social që ata kanë në shoqëri, ku duhet të ketë vëmendje të shtuar të autoriteteve për t'i garantuar akses efektiv në drejtësi.

Në shkurt të vitit 2023, Shqipëria nisi *zbatimin e një harte të re gjyqësore* që reduktoi konsiderueshëm, numrin e gjykatave që operojnë në shkallë të parë dhe bashkoi të gjitha gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm në një. Ky reduktim paraqet *sfida të mëdha për garantimin e procesit të rregullt, pasi duhet të sigurohet që ulja e numrit të gjykatave të mos pengojë qasjen e qytetarëve në drejtësi. Ende mungon një plan i detajuar i shmangies së risqeve të ardhura nga zbatimi i hartës së re gjyqësore.*

Një tjetër element i të drejtës për një proces të rregullt, që ndesh problematika **është përfundimi i procesit brenda një afati të arsyeshëm**. Cilësia dhe efektiviteti i drejtësisë vendoset në pikëpyetje përsa kohë *kohëzgjatja e proceseve* për një numër të madh çështjesh mbetet tepër e lartë. Numri i lartë i vendeve vakante në sistemin gjyqësor ka sjellë si pasojë të drejtpërdrejtë, mbingarkesën e gjykatave dhe shkeljen e të drejtës për të përfunduar procesin brenda një afati të arsyeshëm, por edhe pamundësi shpërndarje të shortit për gjykimin e çështjeve. Sipas raportit të Komisionit Evropian mbi Shqyrtimin Analitik për Grup kapitujt 1 “Themelorët”, një subjekti të së drejtës, i duhen mesatarisht **820 ditë** për të përfunduar një çështje në apel. Referuar raportit mbi Sundimin e Ligjit të KE të vitit 2024, *Gjykata e Lartë* ka ulur numrin e çështjeve të prapambetura me 12% krahasuar me vitin 2023. Megjithatë, mbetet gjykata me numrin më të lartë të çështjeve të prapambetura, konkretisht **31 827** çështje.

Problem serioz mbeten gjithashtu afatet e arsyetimit të vendimit për masat e sigurimit. Nga 1000 raste të analizuara nga INFOCIP, gjatë periudhës 2020-2022, 755 vendime (75.5% e totalit) janë arsyetuar/dorëzuar përtej afatit ligjor.

Mungesa e sistemeve të përshtatshme që shërbejnë për menaxhimin e çështjeve gjyqësore krijojnë një vështirësi të shtuar në funksionimin e gjykatave. Në të njëjtën kohë, përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit për menaxhimin e rasteve, komunikimin e aktorëve të sistemit dhe publikimin e vendimeve është domosdoshmëri.

Problem mbeten gjithashtu prodhimi i statistikave gjyqësore. Metoda statistikore nuk diferencon, llojin e çështjeve për efekt të përlllogaritjes së kohëzgjatjes. Tejkalimit i afatit të gjykimit të arsyeshëm nuk specifikohet as në regjistra dhe as në sistemin aktual të menaxhimit të çështjeve. Nuk ka funksione të kompjuterizuara që të vlerësojnë kohëzgjatjen gjyqësore sipas tipologjisë së çështjes gjyqësore.

Referuar të drejtave procedurale, Parlamenti Evropian ka shprehur shqetësim në lidhje me trajtimin e masave të paraburgimit paraprak dhe **respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë**, një parim thelbësor i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Problem mbetet harmonizimi i legjislacionit dhe praktikës gjyqësore të Shqipërisë me atë të Bashkimit Evropian, veçanërisht me Direktivën (BE) 2016/343. Raporti i Progresit i vitit 2023 e thekson këtë si një problem serioz, duke kërkuar që të ekzistojë një **ndalim ligjor i qartë dhe mjete për të kërkuar kompensim në rast të shkeljes së këtij ndalimi**. Po kështu, Komiteti Parlamentar i Stabilizimit dhe Asocimit BE-Shqipëri, e ka cilësuar problemin e **paraburgimit të zgjatur dhe dënimeve “publike” të individëve para një vendimi gjyqësor në kundërshtim me standardet evropiane**.

Komisioni Evropian thekson gjithashtu domosdoshmërinë e rritjes së pavarësisë së gjyqësorit dhe **forcimit të mekanizmave të mbikëqyrjes gjyqësore**, për të garantuar që vendimet mbi paraburgimin të jenë gjithmonë të bazuara në prova të forta dhe të marrin në konsideratë proporcionalitetin e masës. Parlamenti Evropian shpreh gjithashtu shqetësim lidhur me

ndalimin e të zgjedhurve për të marrë detyrën, në rast hetimi apo për shkak të masave të sigurimit.

Problem thelbësor sa i përket zbatimit efektiv të së drejtës për proces të rregullt është dhe **ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë**. Një faktor tjetër që rëndon procesin është mungesa e burimeve të mjaftueshme për përmbaruesit. Gjithashtu, boshllëqet ligjore dhe problemet procedurale përkeqësojnë situatën. *Kuadri ligjor aktual është i pa përshtatur për realitetin e tanishëm, duke krijuar një konfuzion në zbatim. Vonesa në ekzekutim nuk ka vetëm sa i takon vendimmarrjes vendase (skema shtetërore) por veçanërisht edhe zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ku koha mesatare për zbatimin e një vendimi është 3 vjet e 11 muaj. Shqipëria nuk ka një mekanizëm të qartë dhe të mirëorganizuar për të monitoruar dhe për të ndjekur procesin e zbatimit, çka e bën procesin të fragmentuar dhe të paqëndrueshëm. Pa një strukturë të tillë, shumë vendime të rëndësishme mbeten pezull për periudha të gjata. Për më tepër, kompensimi financiar i përcaktuar nga GJEDNJ shpesh përballet me vonesa të mëdha ose pengesa burokratike. Shqipëria shpesh ka vështirësi në sigurimin e fondeve të nevojshme për të kompensuar palët e dëmtuara, duke krijuar vonesa të panevojshme dhe duke shkelur detyrimet që ka marrë ndaj individëve dhe Gjykatës.*

Referuar garantimit të Ndhmës juridike Falas, pavarësisht përparimeve në sistemin e ofrimit të ndihmës juridike në Shqipëri, raportet e Komisionit Evropian për vitet 2022 dhe 2023 ngrenë një shqetësim të rëndësishëm: *megjithëse ekziston një kuadër ligjor i mirë dhe një strukturë institucionale e krijuar për të garantuar ndihmën juridike falas, arritja të fëmijët mbetet në mënyrë disproporcionale e ulët. Për më tepër, raportet e KE-së theksojnë nevojën për një qasje të ndjeshme ndaj gjinive, në lidhje me viktimat, veçanërisht në kontekstin e çështjeve që përfshijnë dhunën në familje dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) ka shprehur shqetësime në lidhje me zbatimin e ligjit nr.111/2017, veçanërisht në lidhje me viktimat e dhunës me bazë gjinore. Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (ERRC) evidenton se shumë romë nuk kanë besim te sistemi gjyqësor dhe janë shpesh të pa informuar për ligjet ekzistuese dhe mundësitë për ndihmë juridike, duke rezultuar në përdorim të ulët të shërbimeve juridike. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) identifikon barriera të rëndësishme në qasjen në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri, duke vënë në dukje se "mungesa e akomodimeve të përshtatshme dhe teknologjive ndihmëse në procedurat ligjore pengon në mënyrë të konsiderueshme aftësinë e tyre për të marrë pjesë në mënyrë efektive". Sipas të raportit të Fondacionit "Së bashku" vetëm 7% e të gjithë përfituesve të ndihmës juridike falas, janë persona me aftësi të kufizuara. Në aspektin ligjor, korniza aktuale dhe instrumentet për ndihmën juridike falas përballen me sfida të shumta që pengojnë efektivitetin dhe aksesin në këto shërbime, veçanërisht për grupet më të disavantazuara, si viktimat e dhunës në familje, komunitetet rom dhe egjiptian, dhe personat me aftësi të kufizuara.*

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.252/2022 "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të

veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre” ka ndikuar ***në aksesin e qytetarëve në drejtësi***. Një studim i kryer nga Avokati i Popullit ka evidentuar se ky proces vështirëson metodat alternative për marrjen e shërbimeve, ***veçanërisht për individët që nuk kanë akses në teknologji apo njohuri të mjaftueshme kompjuterike***. Kjo është një sfidë e veçantë për të huajt dhe grupet vulnerabël, sidomos në ato raste kur shërbimi online është mënyra e vetme për të mbledhur dokumentacionin e nevojshëm. ***Për këtë arsye, është e domosdoshme që të ofrohen alternativa për aksesin në shërbime bazuar në nevojat e ndryshme të popullsisë***.

Për të përmirësuar sistemin e drejtësisë dhe për të garantuar respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në Shqipëri, nevojiten ndërhyrje të rëndësishme në disa fusha kyçe.

Së pari, nevojitet ***shtimi i numrit të gjyqtarëve dhe plotësimi sa më shpejtë i vendeve vakante***. Për të lehtësuar këtë proces, është e domosdoshme që sistemi të marrë ***më shumë mbështetje financiare dhe burime shtesë për të përballuar ngarkesën***. Përmes riaktivizimit efektiv të skemës së delegimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), mund të mbulohen vakancat në Apel pa vonesa të panevojshme.

Një tjetër fushë për ndërhyrje është ***përshpejtimi i procedurave për zgjidhjen e çështjeve gjyqësore brenda afateve të arsyeshme***. Raportet tregojnë se shumë çështje në Apel dhe në shkallët e tjera gjyqësore zvarriten përtej afateve ligjore, ***duke shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor***. Për të adresuar këtë problem, ***nevojitet rishikimi dhe përditësimi i procedurave gjyqësore*** për të siguruar që çështjet të përfundojnë brenda kohës së përcaktuar nga ligji. ***Përcaktimi i një strategjie urgjente për të adresuar numrin e çështjeve të prapambetura gjyqësore në apel duhet konsideruar si një çështje emergjente***. Përveç kësaj, ***vendosja e mekanizmave të reja për monitorimin e ngarkesës së çështjeve*** do të ndihmonte në ndarjen më të drejtë të punës ndërmjet gjyqtarëve dhe në shmangien e vonesave të panevojshme.

Referuar ***garantimit të prezumimit të pafajësisë*** me rëndësi shihet ***rishikimi i Kodit të Procedurës Penale*** me qëllim harmonizimin e plotë me Direktivën e BE-së nr. 2016/343.

Për të përmirësuar efektivitetin e sistemit, është e domosdoshme ***përmirësimi i teknologjisë së informacionit në gjykata dhe digjitalizimi i proceseve gjyqësore, duke përfshirë menaxhimin elektronik të dosjeve, njoftimet digjitale dhe komunikimin ndërmjet institucioneve***. Kjo do të ndihmonte jo vetëm në përshpejtimin e procesit gjyqësor, por edhe në rritjen e transparencës dhe qasjes së qytetarëve në informacion.

Legjislacioni ekzistues në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore ka nevojë për një rishikim të thellë për të identifikuar boshllëqet dhe paqartësitë që pengojnë ekzekutimin e drejtë dhe në kohë. Një tjetër masë e rëndësishme në këtë drejtim është ***krijimi i një sistemi efikas për monitorimin e shërbimit përmbartimor shtetëror dhe privat dhe mbikëqyrjen e procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore***. Aktualisht, ***mungon një strukturë e dedikuar që të ndjekë vazhdimisht progresin e zbatimit të vendimeve, dhe kjo çon në mungesë***

transparence dhe zvarritje. *Krijimi i një platforme online* ku qytetarët dhe palët e tjera të interesuara mund të *ndjekin ecurinë e vendimeve*, do të ndihmonte në përmirësimin e transparencës dhe rritjen e besimit publik në sistemin e drejtësisë. Me rëndësi është gjithashtu *krijimi i një mekanizmi të dedikuar për monitorimin dhe zbatimin e vendimeve të GJEDNJ*. Është e domosdoshme që një njësi e specializuar brenda Ministrisë së Drejtësisë, të ndjekë progresin e çdo vendimi dhe të sigurojë zbatimin e tij në kohë.

Një aspekt kritik që duhet adresuar është qasja e qytetarëve në drejtësi, veçanërisht pas zbatimit të hartës së re gjyqësore. ***Për të siguruar që të gjithë qytetarët, të kenë qasje të barabartë në drejtësi, pavarësisht vendbanimit të tyre, është e nevojshme të forcohet sistemi i ndihmës juridike.*** Kjo përfshin shtimin e fondeve dhe burimeve për ndihmën juridike, si dhe garantimin që ndihma juridike dytësore të jetë më e aksesueshme për qytetarët që nuk kanë mundësi të përballojnë shpenzimet e avokatëve. Gjithashtu është e nevojshme të investohet në trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve dhe ofruesve të shërbimeve për t'i bërë ata më të aftë, për të trajtuar çështjet më komplekse dhe për të ofruar mbështetje më të specializuar. Rishikimi i kuadrit ligjor mbi ndihmën juridike falas mbetet domosdoshmëri që të adresohen pengesat specifike me të cilat përballen komunitetet vulnerabël, si personat me aftësi të kufizuara dhe komuniteti rom. Përmirësimi i burimeve njerëzore dhe financiare është një aspekt tjetër kyç. Kjo përfshin zgjerimin e rrjetit të qendrave të ndihmës juridike dhe punësimin e më shumë personave, për të përballuar kërkesat në rritje.

Së fundmi, për të siguruar një balancë ***midis riorganizimit gjyqësor dhe qasjes në drejtësi***, është e rëndësishme që ristrukturimi i gjykatave, të shoqërohet me masa për të lehtësuar aksesin në drejtësi, si përmes ofrimit të shërbimeve juridike më afër qytetarëve, ashtu edhe përmes *mekanizmave alternativë për zgjidhjen e konflikteve, si arbitrazhi dhe ndërmjetësimi*. Këto masa do të ndihmonin në uljen e ngarkesës së gjykatave dhe në përmirësimin e efikasitetit të sistemit.

Hartuar nga Ekspertët e Nivelit të Lartë:

Prof.Asoc.Dr. Nadia Rusi
Ph.D Gerti Shella
Ina Xhepa MSc
Oltjon Dano LL.M

Kontribuar ekspertët nga Sekretariati Teknik:

Ina Veleshnja MSc